

Dokument Strategjik
Numër 01 - Dhjetor 2014

PROPOZIM MBI PRIORITETET STRATEGJIKE NË PLANIN E ARDHSHËM TË QEVERISË SË KOSOVËS 2014-2018



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

INSTITUTI PER STUDIME TE AVANCUARA



PËR GSJP

Grupi për Studime Juridike dhe Politike është institut i pavarur, jo-partiak dhe jo-fitimprurës i politikave publike, me seli në Prishtinë, Kosovë. Misioni ynë është që të zhvillojmë studime kredibile në fushën e politikës, së drejtës, dhe ekonomisë, si dhe të ofrojmë rekomandime politikash që mëtojnë të zgjidhin problemet në fushat e caktuara të politikave publike.

PËR GAP

Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think Tank i formuar në tetor të 2007 në Kosovë. Përgjatë këtyre viteve, GAP ka qenë direkt pjesëmarrës në dhjetëra grupe punuese qeveritare për hartim të politikave dhe një numër i madh i dokumenteve publike që tani ndodhen në zbatim njohin kontributin e GAP gjatë procesit të hartimit të tyre. GAP ka publikuar me dhjetëra analiza dhe raporte; GAP u ka dhënë hapësirë për punë një numri të madh të profesionistëve të fushave të ndryshme; publikimet e GAP janë ndër më të cituarat në mediat vendore dhe raporte të ndryshme ndërkombëtare; studiues të shumtë, të cilët merren me zhvillimet politike në Kosovë, kanë cituar publikimet e GAP në studimet e tyre.

Dokument Strategjik, Nr. I, Dhjetor 2014

Propozim mbi Prioritetet Strategjike në Planin e Ardhshëm të Qeverisë së Kosovës (2014-2018)


© Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe Instituti për Studime të Avancuara GAP, Dhjetor 2014.

Opinionet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve të Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe Institutit për Studime të Avancuara GAP, Zyrës së BE-së, stafit, bashkëpunëtorëve ose përfaqësuesve të tyre.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike
Rr. "Rexhep Luci", 10/5
Prishtina 10 000, Kosovo
Web-site: www.legalpoliticalstudies.org
E-mail: office@legalpoliticalstudies.org
Tel/fax.: +381 38 227 944

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rr. "Sejdi Kryeziu", Blloku 4, Kati II
Prishtina 10 000, Kosovo
Web-site: www.institutigap.org
E-mail: info@institutigap.org
Tel/fax.: + 381 38 609 339

Ky dokument është pjesë e projektit: Mbështetje e bashkëpunimit të OJQ-ve dhe Qeverisë së Kosovës në fushën e politik-bërjes, të mbështetur nga Zyra e BE-së në Kosovë.



Projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë. Zbatuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe Instituti për Studime të Avancuara GAP.

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

Përmbajtja

- I. Hyrje
- II. Integrimi Evropian
 - a. Procesi i Liberalizimit të Vizave
 - a.1. Ripranimi dhe riintegrimi
 - a.2. Siguria e Dokumenteve
 - a.3. Menaxhimi i kufirit dhe migrimit
 - a.4. Rendi publik dhe Siguria
 - a.5. Liria e lëvizjes
 - b. Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit
 - c. Migrimi
- III. Shteti Ligjor
 - a. Krimi i Organizuar
 - b. Pasuria e Paligjshme
 - c. Pastrimi i parave
 - d. Korrupsioni Politik.
 - e. Deklarimi i Pasurisë
 - f. Financimi i Partive Politike
- IV. Çështjet politike
 - a. Reforma e Pushtetit Lokal
 - a.1. Komunitet e reja
 - a.2. Reforma financiare e pushtetit lokal
 - b. Reforma e Administratës Publike
 - b.1. Zvogëlimi i Qeverisë
 - b.2. Organizimi i administratës publike
 - b.3. Zvogëlimi i numrit të shërbyesve publik.
 - c. Stabiliteti fiskal dhe transparenca e financave publike
 - d. Politika e jashtme
 - d.1. Raportet me Parlamentin Evropian
 - d.2. Avokimi për interesat e Kosovës në kapitullin 35 të negociatave
 - d.3. Përkrahja e anëtarësimit në Këshillin e Evropës
 - e. Politikat sociale
 - e.1. Strategjia e re për punësim
 - e.2. Politika më të mira social
- V. Çështjet ekonomike
 - a. Zhvillimi Ekonomik
 - b. Ndërmarrjet Publike
 - c. Privatizimi
 - d. Kompleksi Minerar Trepça

- e. Prioritetet e Energjisë
 - e.1. Prodhimi i energjisë
 - e.2. Rritja a efijencës energjetike
 - e.3. Fokusi në ngrohje dhe ftohje
- f. Prokurimi Publik
- g. Tregtia
- h. Investimet e Huaja Direkte
- VI. Përfundim

Propozim mbi Prioritetet Strategjike në Planin e Ardhsëm të Qeverisë së Kosovës (2014-2018)

I. Hyrje

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSJP) dhe Instituti për Studime të Avancuara (GAP) përpiqen të asistojnë në integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian (BE). Ky proces kërkon përfshirjen e politikave që në mënyrë përkatëse pasqyrojnë standardet politike dhe ekonomike të BE-së si dhe rekomandimet e cekura në shumicën e raporteve të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën. GSJP dhe GAP me anë të këtij dokumenti përpiqen të këshillojnë Qeverinë e Kosovës për prioritetet kyçe të cilat duhet të përfshihen në Planin e ardhsëm Strategjik. Në vend të paralelizmit të objektivave të përcaktuara në Raportin e Progresit, rekomandimet e GSJP dhe GAP përqendrohen vetëm në çështjet kyçe të integritit të Kosovës në BE. Miratimi i masave të tilla në vetvete paraqet një numër sfidash të cilat kërkojnë që Qeveria e Kosovës të tregojë përkushtim në avancimin e politikave të cilat renditen me standardet e BE-së.

Me qëllim të realizimit të këtyre qëllimeve, GSJP dhe GAP ofrojnë një listë prioritetesh kyçe për Qeverinë e Kosovës. Në korrik, Qeveria e Kosovës përmbylli negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA), duke shënuar kështu atë që do të njihet si marrëveshja e parë gjithëpërfshirëse me BE. MSA përqendrohet në një numër aspektesh, si përmirësimin e dialogut politik dhe format e reja të bashkëpunimit. Marrë parasysh zgjidhjen e bllokadës politike që ka penguar progresin drejt integritit evropian, nënshkrimi i MSA-së është vendimtar që Kosova të vazhdojë menjëherë rrugën për integrim.

Plani Strategjik i Qeverisë duhet të prioritzojë çështjet kyçe që kanë të bëjnë me integrimin evropian, demokracinë dhe sundimin e ligjit, si dhe ato të aspektit politik dhe ekonomik. Këto çështje jo vetëm që duhet të inkorporohen përmes masave të nevojshme, por zbatimi i tyre duhet të garantohet përmes përcaktimit të objektivave konkrete. Për më tepër, treguesit e përdorur për matjen e suksesit dhe efektivitetit të këtyre synimeve duhet të jenë pjesë thelbësore e Planit Strategjik të Qeverisë.

Për të arritur Integrimin në BE, Qeveria duhet të zbatojë të gjitha propozimet e përfshira në këtë dokument. Së pari, Integrimi Evropian duhet të adresohet, përfshirë diskutimin e MSA si pjesë thelbësore e suksesit të Planit Strategjik. Pastaj, duhet të merret parasysh sundimi i ligjit. Megjithatë, duhet të përmendet se çështjet që kanë të bëjnë me BE nuk janë të ndara nga demokracia, por integrimi duhet të analizohet si një temë e veçantë për shkak

të rëndësishë së integritit për të ardhmen e Kosovës. Në fund, çështjet politike dhe kriteret kyçe ekonomike që do të përfshihen në Planin Strategjik të Qeverisë duhet të merren parasysh gjithashtu.

II. Integrimi Evropian

Kosova ka shënuar progres drejt integritit evropian dhe së fundi ka përmbyllur negociatat për Marrëveshjet e Stabilizimit dhe Asociimit. Në pjesë të mëdha, legjislacioni i Kosovës është në pajtim me standardet evropiane dhe praktikat më të mira. Megjithatë ekzistojnë sfida të cilat Qeveria e Kosovës duhet t'i adresojë menjëherë sa i përket përparimit drejt rrugës për integrim në BE. Çështjet kryesore të cilat duhet të priorizohen në Planin e ri Strategjik përfshijnë reformat e nevojshme lidhur me procesin e liberalizimit të vizave, stabilizimit dhe asociimit, dhe migrimit.

a. Procesi i Liberalizimit të Vizave

Komisioni Evropian ka lansuar një dialog me Kosovën për liberalizim të vizave në janar të vitit 2012 dhe me 14 qershor 2012 i dorëzoi Kosovës udhërrëfyesin drejt një regjimi të lire të vizave. Kosova kishte zbatuar një numër të konsiderueshëm të reformave në 2010 dhe 2011, kryesisht në fushën e ripranimit dhe riintegritit, të cilat bënë që Komisioni të lansojë këtë dialog në vitin 2012. Megjithatë, qytetarët e Kosovës mbesin të vetmit në Ballkan të cilët duhet të marrin vizë udhëtimi që si pasojë kufizon gatishmërinë dhe mundësinë e tyre për të udhëtuar në vendet evropiane. Gjatë dy viteve të fundit, institucionet e Kosovës kanë punuar për të arritur standardet e përmendura në udhërrëfyesin e vizave; megjithatë, raporti i fundit i Komisionit Evropian tregoi se një numër i tyre nuk është realizuar ende.

a.1. Ripranimi dhe riintegrimi

Objektivi 1: Qeveria duhet të vazhdojë të zbatojë Ligjin për Ripranim dhe të gjitha marrëveshjet tjera për ripranim me vendet e BE-së.

Objektivi 2: Qeveria duhet të shpërndajë fondin e riintegritit për shërbime të qëndrueshme riintegruese (arsimim, trajnime profesionale dhe asistencë punësimi) dhe të zhvillojë një sistem të menaxhimit të rasteve të riintegritit i cili mundëson përcjelljen e shërbimeve të ofruara për të gjithë përfituesit e regjistruar.

a.2. Siguria e Dokumenteve

Objektivi 1: Qeveria duhet të përmirësojë funksionimin e Sistemit të Regjistrimit të Gjendjes Civile, duke siguruar kështu cilësi dhe konsistencë në të dhënat e ruajtura.

Objektivi 2: Qeveria duhet të elaborojë procedurat standarde të veprimit për ruajtjen dhe lidhjen e dokumenteve themelore në regjistrin civil.

a.3. Menaxhimi i kufirit dhe migrimit

Objektivi 1: Qeveria duhet të zbatojë të gjitha ligjet dhe rregulloret lidhur me menaxhimin e kufirit dhe migrimin.

Objektivi 2: Institucionet e Kosovës duhet të kryejnë kontrole sistematike të kufirit në vijën e trafikut hyrës dhe dalës, dhe të elaborojnë procedurat standarde të veprimit për regjistrimin e udhëtarëve me qëllim të parandalimit të migrimit jo të rregullt dhe trafikimit me qenie njerëzore.

Objektivi 3: Të azhurnohen dhe kombinohen bazat e të dhënave për migrim dhe azil dhe t'u lejohet qasja në bazën e të dhënave të gjitha autoriteteve përkatëse.

a.4. Rendi publik dhe Siguria

Objektivi 1: Qeveria duhet të miratojë Ligjin për Përgjim dhe procedurat standarde të veprimit me anë të legjislacionit sekondar, të cilat duhet të jenë në pajtim me praktikat më të mira evropiane.

Objektivi 2: Të zhvillojë sistemin e integruar të menaxhimit të rasteve për të përcjell lëndët penale nga hetimi deri në zgjidhje dhe të përmirësojë këmbimin e informatave në mes të autoriteteve për zbatim të ligjit dhe atyre gjyqësore.

Objektivi 3: Të përmbyllë marrëveshjet tjera të bashkëpunimit në fushën e zbatimit të ligjit dhe të fuqizojë bashkëpunimin operacional me vendet evropiane dhe vendet anëtare të BE-së si dhe të vazhdojë bashkëpunimin me EUROPOL, INTERPOL dhe organet regjionale për zbatim të ligjit.

Objektivi 4: Të themelojë regjistrin për përcjelljen e vendimeve gjyqësore për rastet trafikimit me qenie njerëzore, trafikimit të drogës, korrupsionit, prokurimit publik dhe shpëlarjes së parasë, përfshirë dënimet e ekzekutuara penale dhe marrjes së aseteve të përfituara me anë të veprës penale.

a.5. Liria e lëvizjes dhe të drejtat e njeriut

Objektivi 1: Qeveria duhet të miratojë dhe zbatojë ligjet kundër diskriminimit dhe barazisë gjinore dhe ndryshimet në ligjin për Ombudspersonin.

Objektivi 2: Qeveria duhet të sigurojë që qytetarët kanë qasje në informata të qarta për të drejtat dhe kompensimet e tyre ligjore.

b. Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit

Kosova është vendi i fundit i Ballkanit pa një marrëveshje të MSA me Bashkimin Evropian. Deri më tani, BE ka nënshkruar MSA me Maqedoninë, Kroacinë,

Shqipërinë, Malin e Zi, Serbinë dhe Bosnje dhe Hercegovinën. Secila marrëveshje identifikoi synimet e përbashkëta ekonomike dhe politike, inkurajoi për një bashkëpunim rajonal dhe krijoi zonën e lire të tregut në mes të BE dhe këtyre vendeve. Përderisa MSA-të ekzistuese ishin krijuar për vende individuale, ato janë mjaft të ngjashme dhe përmbajnë synime të njëjta. Kjo do të jetë marrëveshja e pare kontraktuale në mes BE-së dhe Kosovës; marrëveshje e cila kërkon përkushtim të të dyja palëve lidhur me rrjedhën veprimit të përshkruar në hollësi në MSA. Përveç kësaj, Kosova do të jetë në gjendje të liberalizojë tregun me të gjitha vendet anëtare të BE-së, të fuqizojë bashkëpunimin rajonal duke renditur preferencat e veta politike dhe ekonomike me vendet tjera dhe të zbatojë kornizën më të përshtatshme institucionale për adresimin e konkurrencës së jashtme.

Objektivi 1: Qeveria duhet të nënshkruajë MSA brenda tre (3) muajve dhe të fillojë me zbatimin e të gjitha çështjeve të dakorduara.

Objektivi 2: Qeveria duhet të hartojë dhe të zbatojë në tërësi Planin e ri të Veprimit për MSA.

Objektivi 3: Qeveria duhet të fuqizojë institucionet, kapacitetin dhe mjetet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga MSA.

Objektivi 4: Qeveria duhet të sigurojë që detyrat e institucioneve janë reale sa i përket resurseve në dispozicion

c. Migrimi

Kryesisht, për shkak të kushteve jo të favorshme ekonomike në Kosovë, kosovarët kanë tendencë të largohen nga vendi i tyre. Për më tepër, edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare të kërkesave për azil, trendi i numrit të emigrantëve të paligjshëm që kërkojnë azil në shtetet anëtare të BE-së është rritur. Qytetarët e Kosovës kanë përdorur Beogradin si rrugë-lidhëse me vendet e BE-së. Kjo kërkon koordinim të ngushtë në mes të institucioneve të Kosovës dhe EULEX-it në njërën anë, dhe institucioneve Serbe në anën tjetër për të identifikuar individët që organizojnë kalimin ilegal të kufirit nga Serbia në vendet e Bashkimit Evropian. Përveç kësaj, destinacionet kryesore për kërkim të azilit janë konsideruar të jenë Hungaria, Gjermania, dhe vendet skandinave, mes tjerash. Thënë këtë, më të prirur të emigrojnë janë banorët e Mitrovicës, ata që jetojnë në zonat rurale, individët e pakënaqur me kushtet e tyre aktuale të jetesës, individët e moshës 15-24, dhe individët me të ardhura mujore deri në €200.

Objektivi 1: Qeveria duhet të prezantojë një strategji substanciale dhe një kampanjë të vazhdueshme informative që i informon popullatën për politikat e

migracionit të BE-së. Ky hendek në shpërndarjen e informatave duhet të adresohet nga Qeveria e Kosovës përmes fushatave të ndërgjegjësimit të cilat do të përmirësojnë gjendjen aktuale.

Objektiva 2: Qeveria e Kosovës duhet të përqendrohet në ofrimin e punësimit afatshkurtër për individët e moshës 15-24 vjeçare në mënyrë që të ndryshojë perceptimin e tyre që vendet e BE-së janë destinacioni më tërheqës sa i përket mundësive për punësim. Vëmendje të veçantë duhet kushtuar programeve arsimore të cilat këshillojnë dhe trajnojnë këtë kategori të popullatës duke mundësuar orientimin e tyre në tregun e punës.

Objektiva 3: Qeveria e Kosovës duhet të trajtojë punësimin në zonat rurale me prioritet më të lartë duke ofruar mundësi arsimore për këtë kategori të popullatës, në veçanti mundësi të arsimit profesional. Theks të veçantë duhet t'i kushtohet rajonit të Mitrovicës, Gjakovës dhe Skenderajt, dhe atyre regjioneve ku mundësit e punësimit janë të pakta.

III. Shteti Ligjor

Në mënyrë që Kosova të jetë e suksesshme si një demokraci, sundimi i ligjit duhet të forcohet. Ndërsa legjislativi i Kosovës është kryesisht në përfrim me standardet evropiane, zbatimi mbetet një çështje e rëndësishme. Për t'u siguruar që sundimi i ligjit është adresuar sa duhet në planin e ardhshëm strategjik të qeverisë, tri fusha të rëndësishme duhet të trajtohet duke përfshirë: krimin e organizuar, pasurinë e paligjshme, korrupsionit politik dhe deklarimin e pasurisë. Këto çështje nuk duhet të përfshihen vetëm në strategjinë e qeverisë, por duhet të vlerësohet në mënyrë të mjaftueshme për të siguruar zbatimin e qëllimeve të përcaktuara nga Qeveria e Kosovës.

a. Krimi i Organizuar

Krimi i organizuar është një kërcënim për stabilitetin dhe sigurinë në Kosovë, dhe është përcaktuar me Kodin Penal si një krim i rëndë i kryer nga një grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, një dobi financiare apo materiale.

Objektivi 1: Qeveria duhet të forcojë dhe mbështesë institucionet që merren me krimin e organizuar (njësive të hetimit të Policisë së Kosovës dhe institucioneve tjera ekzekutive), duke siguruar trajnim gjithëpërfshirës brenda 6 muajve të futjes së planit të ri të qeverisë. Duhet të ketë vlerësimi strategjik të statistikave gjithëpërfshirëse dhe vlerësim të trajnimeve institucionale, me konsideratë në marrjen e komenteve anonime të siguruar nga pjesëmarrësit.

Objektivi 2: Qeveria duhet t'i jap vëmendje parandalimit dhe zbulimit të krimit të organizuar duke ngritur vetëdijen e stafit institucional dhe publikut të gjerë me

anë të fushatave edukuese brenda një viti të finalizimit të Planit Strategjik. Duhet të ketë vlerësim të ndryshimeve, njëlloj, në staf institucional dhe në perceptimin e popullatës së përgjithshme për krimin e organizuar, si dhe numër të rasteve të raportuara në lidhje me çështje të ndërlikuara të kimit të organizuar.

Objektivi 3: Bashkëpunimi dhe koordinimi duhet të përmirësohet në mes të institucioneve që trajtojnë krimin e organizuar nëpërmjet vendosjes së një baze të dhënash të përbashkët të informacionit brenda 1 viti nga futja në fuqi e planit strategjik. Kujdes duhet dhënë me numrin e arrestimeve dhe dënimeve që janë arritur përmes bashkëpunimit të institucioneve të ndryshme, me vëmendje të veçantë në numrin e dënimeve që përfshijnë zyrtarë të lartë të Qeverisë.

b. Pasuria e Paligjshme

Problemi i pasurisë së paligjshme duhet të trajtohet në mënyrë efektive nga qeveria e Kosovës për të mbështetur luftën kundër kimit të organizuar dhe korrupsionit politik. Edhe pse ligjet në lidhje me konfiskimin e pasurisë së paligjshme janë në përputhje me standardet evropiane, zbatimi mungon.

Objektivi 1: Një sistem i bazuar NË JO FAJËSINË (non-conviction based system) duhet të jetësohet në mënyrë që të konfiskohen pasurinë e paligjshme dhe për të privuar individët e pasurive të fituara ilegalisht që të shfrytëzojnë këtë. Në vlerësimin e efektivitetit të këtij ligji, konsideratë duhet t'i jepet nëse zyrtarët publikë të nivelit të lartë janë duke u ndjekur penalisht.

Objektivi 2: Një barrë e zhvendosur e provës duhet të lejohet me ligj në raste të konfiskimit, ku të pandehurit janë të detyruar të provojnë origjinën e ligjshme të aseteve në fjalë. Përfshirja e një barrë lëvizëse të provës në ligj do të tregojë se qeveria ka pasur sukses në këtë çështje. Konsideratë më tej duhet të jepet me numrin e rasteve dhe dënimeve për pasuri të paligjshme, dhe duhet të vlerësojnë jo vetëm numrat, por ashpërsia e krimeve duke u ndjekur penalisht.

Objektivi 3 : Një afat kohor për sekuestrimin e aseteve duhet të futet në ligj për të siguruar që masat për të luftuar pasuri të paligjshme janë efikase dhe në kohë, duke inkurajuar rritjen në ndjekjen penale të rasteve të tilla.

c. Pastrimi i parave

Korniza aktuale legjislative e Kosovës në pastrimin e parave ballafaqohet me mangësi të ndryshme që pengojnë luftimin e duhur të kimit të njohur ekonomik. Më saktësisht, mangësitë e shumta që hasen janë të lidhura me kujdesin e duhur ndaj klientit 'Customer Due Diligence', reagimet nga Njësia për Inteligjencë Financiare, konfiskimin e aseteve, treguesit statistikorë dhe

trajnimet e veçanta për të punësuarit/zyrtarët e ngarkuar me trajtimin dhe parandalimin e shpëlarjes të parave si dhe masat e përshtatshme dhe të mjaftueshme mbrojtëse për punonjësit/zyrtarët e lartpërmendur. Për më tepër, nuk ka asnjë bazë të përbashkët të të dhënave për të gjitha institucionet që luftojnë pastrimin e parave, numri i prokurorëve që merren me këto çështje është shumë i ulët dhe trajnimet shtesë janë të nevojshme, vonesa të konsiderueshme në raportim nga ana e institucioneve financiare janë identifikuar, kurse bashkëpunimi në mes të institucioneve që luftojnë pastrimin e parave në Kosovë është konsideruar të jetë i mirë, por ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm. Qeveria duhet të:

Objektivi 1: Të ndryshojë ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit brenda tre (3) muajve të parë pas formimit të Qeverisë.

Objektivi 2: Të sigurojë një mënyrë të hapur për ndihmë financiare në mënyrë që Këshilli Prokurorial të punësojë, sa më shpejt që të jetë e mundur, prokurorë shtesë të specializuar dhe të sigurojë trajnime më të avancuara për prokurorët dhe të gjithë zyrtarët e tjerë të ngarkuar me luftimin e pastrimit të parave.

Objektivi 3: Të hartojë një udhëzim administrativ për ndëshkrimin e duhur ligjor ndaj institucioneve financiare që vonojë raportimin e transaksioneve të dyshimta të Njësia për Inteligjencë Financiare.

Objektivi 4: Të krijojë një bazë të përbashkët të të dhënave për të gjitha institucionet që luftojnë veprat penale të pastrimit të parave në mënyrë që ato të jenë më të informuara për rastet e raportuara, analizuara, hetuara, hedhura poshtë, dhe ndjekura penalisht.

d. Korrupsioni Politik

Ndryshimet duhet të bëhen për të trajtuar problemin e vazhdueshëm dhe të rëndë të korrupsionit politik në Kosovë. Financimi i partive politike duhet të bëhet i hapur dhe transparent në mënyrë që interesat e veçanta të atyre që ju dhurojnë partive politike të mos jenë në gjendje për të ndikuar padrejtësisht në procesin zgjedhor (më shumë mbi këtë temë referoju seksionit mbi financimin e partive politike).

Objektivi 1: Zgjedhjet duhet të zhvillohen në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe qeveria duhet të kalojë një ligj që përfshin detaje specifike në lidhje me numërimin, tabelën, certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, procedurat për anulimin e zgjedhjeve, dhe njoftimin për ngjarjet publike

Objektivi 2: Qeveria e Kosovës duhet të implementojë një kod sjelljeje për të gjithë politikanët, dhe kodin ekzistues të mirësjelljes për anëtarët e Kuvendit duhet të zbatohet nëpërmjet krijimit të një organi të mbikëqyrës brenda një viti.

Një kod i mirësjelljes duhet të jetë i mishëruar në legjislacionin për politikanët për të ju bërë presion që të sillen në mënyrë etike, dhe të krijohet një trup për mbikëqyrjen e Kuvendit.

e. Deklarimi i Pasurisë

Kosova rangohet si vend me nivel shumë të lartë të korrupsionit nga indikatorë ndërkombëtar duke përfshi këtu edhe “Corruption Perception Index” nga Transparency International, dhe raportet tjera siç është Raporti i Bashkimit Evropian i cili vlerëson progresin/regresin e rrugës Evropiane të Kosovës. Prandaj, zhvillimi i një strategjie kundër korrupsionit duhet të përfshijë edhe politikën e deklarimit të asetëve, dhe njëkohësisht kjo duhet të jetë pjesë e listës së prioritetëve. Momentalisht, kjo është një politikë e lënë anash, përkundër faktit që pasuria e zyrtarëve të lartë publik është mbledhur në mënyrë të pashpjegueshme për disa vite dhe perceptimit të zakonshëm të përhapur në mesin e qytetarëve të Kosovës se zyrtarët publik përfaqësojnë shtresën shoqërore më të pasur. Sistemi i deklarimit të pasurisë ballafaqohet me shumë probleme duke përfshirë terminologjinë kontradiktore që përdoret për të mbushur formularët, përcaktimin e pabazuar të vlerave të pronës pa marrë në konsideratë vlerën e tregut, mungesën e një procesi të qartë të verifikimit apo udhëzimeve që vlerësojnë saktësinë e deklaratave, mungesën e një procedure të paanshme për të vendosur se cilat deklarata të vlerësohen dhe mungesën e legjislacionit dhe udhëzimeve që identifikojnë kursin e veprimit për trajtimin e zyrtarëve publik me pasuri të tepruar që nuk ka bazë të saktë të prejardhjes. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet:

Objektiva 1: Të sigurojë që Agjencia Kundër Korrupsionit të vendosë një mekanizëm që do të ndihmojë të përcaktojë vlerën reale të pronave. Kjo, nga ana tjetër, nuk iu mundëson zyrtarëve publik që të ofrojnë vlera të pasakta të pronave që nuk lidhen me vlerën reale të tregut apo vlerën e përbashkët të pronave.

Objektiva 2: Të sigurojë që Agjencia Kundër Korrupsionit të vendosë udhëzime të qarta për procesin e verifikimit të deklarimit të pasurisë.

Objektiva 3: Të sigurojë që Agjencia Kundër Korrupsionit dhe institucionet tjera relevante siç është Ministria e Punëve të Brendshme, të vendosë bashkëpunim ndërkombëtar për shkëmbim të informacionit. Kosova duhet të bëjë prioritet vendet në rajon, pasi që ka gjasa më të mëdha që një zyrtar publik do të blejë pasuri apo do të mbajë llogari në një vend tjetër Ballkanik për shkak të afërsisë, familjaritetit me kulturën dhe procedurat, dhe rrjetin e afërt.

f. Financimi i Partive Politike

Korniza legislative mbi financimin e partive politike si dhe zbatimimi i saj i duhur janë shumë të rëndësishme për demokracinë në tranzicion. Në Kosovë, financimi i partive politike është pjesë e akuzave për korrupsion dhe keqmenaxhim. Siç ishte rasti edhe në vendet tjera në tranzicion, financimi i partive dhe organizatave politike në Kosovë është shndërruar në shqetësim të madh dhe ka nevojë për reformë të vazhdueshme, përfshirë këtu edhe ndryshimet në legjislacionin, në mënyrë që, të paktën, të sigurohet doza e mjaftueshme e legjitimitetit dhe stabilitetit në sistemin politik. Deri më tani, në Kosovë janë evidentuar shumë parregullsi tek partitë politike, sidomos në shfrytëzimin e pozitave publike dhe resurseve për të shtyrë përpara agjendat e tyre politike.

Objektiva 1: Qeveria e Kosovës duhet të mbështesë institucionet dhe të ofrojë mekanizma për të zbatuar Ligjin mbi Financimin e Partive Politike nga të dyja palët, partitë politike dhe aktorët e tjerë të përfshirë, sidomos gjatë fushatave zgjedhore.

Objektivi 2: Një formë e standardizuar për raportimin financiar duhet të mandatohet me ligj brenda 6 muajve, dhe çdo parti që nuk vepron në përputhje me ligjin duhet të sanksionohet. Duhet të merret në konsideratë nëse ka një rritje të numrit të sanksioneve të shqiptuara për raportim të pasaktë apo në kundërshtim me ligjin.

Objektiva 3: Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë mjete financiare dhe kapacitete humane për Komisionin Qendror Zgjedhor, në mënyrë që kjo e fundit të përmbush detyrat e saj në mënyrë efikase. Kjo do të përmirësonte zbatimin e procesit të monitorimit të partive politike dhe të konformitetit të tyre me kuadrin legjislativ.

Objektiva 4: Kosovës i mungojnë mekanizma të kontrollit mbi financimin e partive politike. Për këtë arsye, është thelbësore që të përfshihen institucione tjera, përveç agjencioneve për auditim, që do të pranojnë, hetojnë dhe shqyrtojnë raportet financiare të partive politike. Më saktësisht, fondi demokratizimi ('paratë publike') i cili i shpërndahet partive politike duhet të auditohen, përveç nga auditori privat, poashtu edhe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm apo institucionet e tjera kompetente në shqyrtimin dhe auditimin e parave publike.

Objektiva 4: Qeveria e Kosovës duhet, brenda 6-12 muajve të prezantimit të planit të ri strategjik të qeverisë, të krijojë një sistem i cili shpall listat e donatorëve të ndaluar dhe atyre të lejuar, si dhe listën e subjekteve private në marrëdhënie kontraktuale me institucionet e Republika e Kosovës për ofrimin e

mallrave dhe shërbimeve. Kjo do të mundësojë institucionet përgjegjëse që të kontrollojnë rrjedhjen e parasë në parti politike.

IV. Çështjet politike

Përderisa përpjekjet politike të Kosovës janë përqendruar në zgjidhjen e bllokadës politike, është me rëndësi që Qeveria të lëvizë përpara me reforma politike me qëllim të përmirësimit të strukturës së qeverisë, imazhit të saj dhe gatishmërisë për t'i shërbyer qytetarëve të Kosovës. Çështjet e rëndësishme që duhet të adresohen me anë të planit strategjik janë qeveritë lokale, reformat e administratës publike, stabiliteti fiskal dhe transparenca e financave publike, politika e jashtme dhe përmirësimet në politikat sociale/të punësimit.

a. Reforma e Pushtetit Lokal

Bazat e funksionimit të Pushtetit Lokal në Kosovë janë vendosur gjatë Administrimit Ndërkombëtar nga ana e UNMIK-ut dhe disa ndryshime të pjesshme janë bërë gjatë vitit 2007 të cilat kanë nisur të zbatohen me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës. Reformë të gjera në këtë nivel të pushtetit nuk ka pasur, ndonëse gjithë përfaqësuesit e komunave kanë shfaqur nevojën e nisjes së një reforme thelbësore të Pushtetit Lokal me qëllim të rritjes së efektivitetit dhe evitimin normativ të mangësive të hasura. Në kuadër të kësaj reforme e pushtetit lokal do të duhej të konsistonte në ndryshimin e statusit ligjor të Prishtinës, ndaljen e themelimit të komunave të reja, riorganizimin e numrit të te punësuarave, dhe reforma fiskale e financiare në pushtetin lokal. Kushtetuta e Kosovës në nenin 13 parasheh që statusi dhe organizimi i Kryeqytetit duhet të rregullohet me Ligji të veçantë. Një draft i këtij Ligji është hartuar në fund të vitit 2009 i cili ka kaluar në leximin e parë në Kuvend (korrik 2010), pas shqyrtimit të dytë në Komisionin e Kuvendit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media është vendosur që drafti t'i kthehet Qeverisë për ndryshim/plotësim. Nga ajo kohë, ndonëse ka qenë pjesë e Strategjive Legjislative të ekzekutivit, Kuvendi nuk ka pranuar ndonjë draft të ri të këtij Projektligji. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) gjatë periudhës prill-shtator të këtij viti (2014) ka mbledhur një grup punues mes eksperteve, përfaqësueseve të shoqërisë civile dhe komunës së Prishtinës të cilët kanë harmonizuar pikëpamjet rreth përmbajtjes që duhet të këtë Projektligji për Prishtinën. Mungesa e këtij Ligji është vlerësuar t'i shkaktojë humbje buxhetore Kryeqytetit dhe krijon probleme në fuqizimin administrativ të kryeqytetit.

Objektivi 1: Projektligji për Prishtinën duhet t'i jap pozitë asimetrike kryeqytetit në raport me komunat e tjera të vendit.

Objektivi 2: Projektligji për Prishtinën duhet të specifikojë obligimet e nivelit qendror që të ndajë buxhet shtesë për Prishtinën në përputhje me statusin e kryeqytetit. Shuma e ndarë nga niveli qendror nuk duhet të jetë me pak se 4% e

grantit total të komunave. Shuma shtesë e dedikuar duhet shpenzuar vetëm për investime kapitale.

Objektivi 3 Projektligji duhet të parasheh krijimin e një njësie përkatëse policore në shërbim të Prishtinës, veçmas në fushën e trafikut, ndërtimeve, pronës publike dhe zhurmës gjatë orëve të natës.

a.1. Komunat e reja

Tendenca e themelimit të komunave të reja në Kosovë pas vitit 2010 përgjithësisht ka qenë proces i politizuar dhe nuk është përcëlluar me analiza përkatëse ligjore e buxhetore. Themelimi i komunave të reja në gjendjen ekzistuese rrit numrin e stafit civil, përderisa rekomandimet e FMN-se konsistojnë në zbritjen e këtij numri, krijon probleme në qarkoren buxhetore për komunat, zbritet nivelin e të hyrave komunale për disa nga komunat ekzistuese dhe krijon komuna që mbesin të varura financiarisht nga niveli qendror, praktik kjo që bje ndesh me tendencën e fuqizimit të komunave dhe pavarësimin financiar të tyre në raport me nivelin qendror.

Objektivi 1: Vendimet e deritanishme të qeverisë për themelimin e komunave të reja duhet anuluar.

Objektivi 2: Qeveria e Kosovës nuk duhet të marr vendim për krijimin e komunave të reja në rast se nuk ekziston një studim i plotë fizibilitet. MAPL, Ministria e Financave dhe ministrinë tjera duhet të vlerësojnë kërkesat e secilës bashkësi të fshatrave, nëse komuna e re plotëson kriteret bazë ligjore, është e qëndrueshme financiarisht, nuk krijon barrë shtesë për buxhetin, të vlerësohet gjendja në arsim, shëndetësi, ekonomi etj.

Objektivi 3: Komunat, në bashkëpunim me nivelin qendror, duhet të bëjnë të mundur ofrimin e shërbimeve administrative dhe investimeve kapitale edhe në lokalitetet rurale, sidomos në ato lokalitete të cilat gjenden më larg qendrës urbane dhe ndihen të diskriminuara nga ndarjet buxhetore apo nga ofrimi i shërbimeve administrative, arsimore dhe shëndetësore.

a.2. Reforma financiare e pushtetit lokal

Një ndër problemet më të theksuara në nivelin lokal është paraqitur ai financiar i cili jo domosdoshmërisht lidhet me pamundësinë financiare të komunave për investime, por në menaxhimin e kapaciteteve financiare dhe në përdorimin efikas të këtyre burimeve, probleme këto që kanë rrjedhur përgjithësisht për arsye të procedurave të shumta dhe ndikimit në vendimmarrje nga niveli qendror. Thelbi i reformës lokale konsiston në reformën financiare.

Objektivi 1: Ministria e Financave duhet të ndryshojë bazën ligjore dhe t'u mundësojë komunave që vetë ato ta planifikojnë shumën totale të të hyrave

komunale dhe mënyrën e shpenzimit të të hyrave. Ministria e Financave duhet ta largoj 'tavanin' në të hyrat komunale, komunat duhet të mbesin të pavarura në përcaktimet e tyre për shkallen e mjeteve që mund t'i vjelin për një periudhën një vjeçare.

Objektivi 2: Ministria e Financave duhet të ndryshojë bazën ligjore dhe të parashih se tek kategoria e investimeve kapitale periudha fiskale nuk zgjat 12 muaj, por duhet të rritet në 24 muaj. Kjo duhet të bëhet me qëllim që të evitohet bartja e mjeteve nga një vit në tjetrin dhe të evitohet praktika e tanishme e disa komunave që të nisin projekte vetëm me qëllim të shpenzimit të mjeteve.

Objektivi i 3: Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit lokal duhet të krijojnë një asimetri pagash në nivelin komunal. Drejtoret e Drejtorive, Kryetaret, Nënkryetaret dhe Asamblistët duhet paguar në bazë të kriterëve që mund të jenë madhësia e territorit, numri i banorëve dhe numri i shërbimeve dhe shuma e mjeteve të vjela gjatë një viti.

Objektivi 4: Ministria e Financave dhe ministrat tjerë përkatëse të modifikojnë mënyrën (fushat, sektorët) prej nga vjelin të hyra komunat, me qëllim që të forcohet baza financiare e komunave dhe të ulet përqindja e buxhetit qendror që dedikohet për komuna.

b. Reforma e Administratës Publike

Reforma e Administratës Publike është mjaft e rëndësishme për Kosovën në kuptim të funksionimit të shtetit dhe organizimit si dhe arritjes së ndërmarrjes së reformave me qëllim të përmbushjes së obligimeve të MSA. Sa i përket kornizës strategjike të reformës së administratës publike, ajo në masë të madhe ekziston, për zbatimin e saj mbetet mjaft i dobët. Përveç raportit të progresit të KE për Kosovën, reforma në administratën publike është njëra nga tri shtyllat e strategjisë së KE për zgjerim 2014-2015. Me qëllim të sigurimit të reformës së administratës publike, duhet të adresohen tri prioritete: zvogëlimi i Qeverisë, organizimi i administratës publike dhe zvogëlimi i numrit të shërbyesve civilë në institucionet publike.

b.1. Zvogëlimi i Qeverisë

Qeveria e Kosovës ka një numër të madh të ministrive i cili numër është rritur që nga themelimi i saj më 2001. Nga nëntë (9) ministri në 2001, sot ekzistojnë nëntëmbëdhjetë (19) ministri dhe një (1) ministër pa portfolio. Përveç numrit të madh të ministrive, Qeveria e Kosovës aktualisht ka pesë (5) zëvendës kryeministra dhe secila ministri ka së paku dy (2) zëvendës ministra. Ky numër i madh i ministrive, zëvendës ministrave dhe zëvendëskryeministrave rezultojnë nga mungesa e Ligjit për Qeverinë që do të përcaktonte rregullore të rrepta për

themelimin e ministrive të reja. Me qëllim të adresimit të këtij prioriteti, duhet të përmbushen dy (2) synime përfshirë krijimin e Ligjit për Qeverinë dhe ristrukturimin /zvogëlimin e Qeverisë.

Objektivi 1: Duhet të hartohet Ligji për Qeverinë dhe të miratohet nga Kuvendi. Përveç aspekteve tjera, ky ligj duhet të adresojë në veçanti dy (2) çështje: 1) themelimin e ministrive të reja (ku Kuvendi do të duhej të ishte autoriteti final për themelimin e ministrive të reja), dhe 2) ky ligj duhet të specifikojë detyrat e Qeverisë në ikje .

Objektivi 2: Madhësia aktuale e Qeverisë duhet të ristrukturohet dhe zvogëlohet. Numri i ministrive duhet të zvogëlohet nga nëntëmbëdhjetë (19) në trembëdhjetë (13) ministri, nga pesë (5) në një (1) zëvendëskryeministër dhe një (1) ose dy (2) zëvendës ministra për çdo ministri (varësisht nga madhësia e portfolios së ministrisë).

b.2. Organizimi i administratës publike

Organizimi i administratës publike asnjëherë nuk është adresuar ndonëse ka qenë pjesë e programit të qeverisë 2011-2014. Përveç numrit të madh të ministrive të diskutuar më sipër (që nënkupton rritjen e strukturave dhe organeve të administratës publike) ministrinë themelojnë agjencitë e veta ekzekutive që në shumicën e rasteve kjo krijon struktura të dyfishta me ministrinë. Ekzistojnë rreth gjashtëdhjetë e tetë (68) organe publike të referuara si agjenci apo agjenci ekzekutive (kryesisht si pjesë e ministrive) të cilat nuk janë të rregulluara me anë të ndonjë ligji të caktuar. Me qëllim të adresimit të organizimit të administratës publike, duhet të rishikohet baza ligjore për agjencitë dhe agjencitë ekzekutive dhe agjencitë e tepërta duhet të eliminohen.

Objektivi 1: duhet të vlerësohet një bazë e qartë ligjore për themelimin e agjencive ose agjencive ekzekutive si pjesë të ministrive. Ligji për Administratën shtetërore duhet të rishikohet, dhe nuk duhet të përdoret si bazë ligjore për themelimin e agjencive të tilla. Duhet të bëhet dallimi në mes të administratës shtetërore dhe administratës publike.

Objektivi 2: duhet të elimonihet një numër i agjencive të tilla. Këto agjenci duhet të rishikohen për të përcaktuar synimin dhe qëllimin e tyre, dhe ato agjenci që krijojnë tepërcë brenda departamenteve të ministrisë duhet të eliminohen.

b.3. Zvogëlimi i numrit të shërbyesve publik

Përveç numrit të madh të ministrive dhe organeve publike në administratën publike, ekziston poashtu një numër i madh i shërbyesve publik. Ekzistojnë rreth 78,752 shërbyes publik të punësuar në administratën publike në nivele qendrore dhe lokale. Shërbyesit civil nuk janë të shpërndarë në bazë të

nevojave dhe përgjegjësive të një ministrie të caktuar ose agjencie. Për shembull, Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil si njësi qendrore për politikatat e shërbimit civil i krijuar në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike (MAP) ka 25 punonjës (shërbyes civil) ndërsa Agjencia e Shoqërisë së Informacionit gjithashtu pjesë e MAP ka 60 punonjës. Këto çështje duhet të adresohen si prioritetet kyçe në Planin Strategjik të Qeverisë.

Objektivi 1: Qeveria, përmes MAP duhet të themelojë një plan të zvogëlimit të numrit të shërbyesve civil. Kur shërbyesit civil të pensionohen në moshën 65 vjeçare, pozitat e tyre nuk duhet të plotësohen me shërbyes të ri civil. Përgjegjësitë dhe detyrat e pozitave të tilla duhet t'u ndahen personelit ekzistues dhe nuk duhet të punësohen shërbyes të ri civil. Në bazë të statistikave të siguruara nga MAP, 5,867 shërbyes civil do të arrijnë moshën e pensionimit gjatë periudhës 2014-2018. Ky plan do të rezultojë në uljen graduale të numrit të shërbyesve civil të cilët punojnë në administratën publike të Kosovës.

Objektivi 2: Rishpërndarja e shërbyesve civil (bashkë me organizimin e administratës publike) duhet të jetë pjesë e planit. Nevojat ekzistuese dhe sasia e punës së institucioneve duhet të jenë shtytës për rekrutimin e shërbyesve të ri civil.

c. Stabiliteti fiskal dhe transparenca e financave publike

Deri më tani Qeveria e Kosovës ka arritur të mbajë një politikë fiskale stabile. Megjithatë, pagat e punëtorëve të sektorit publik janë rritur para zgjedhjeve të përgjithshme dy (2) herë pa ndonjë shpjegim ose arsyetim. Në anën tjetër, llogaridhënia e organizimit të buxhetit lidhur me shpenzimet buxhetore është e nivelit më të ulët. Si shembull, shumica e organizatave buxhetore nuk përmbushin obligimet ligjore lidhur me publikimin e raporteve financiare tremujore.

Objektivi 1: Me qëllim të shmangies së jostabilitetit fiskal dhe përdorimit të parasë publike për qëllime politike, në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Llogaridhënie (LMFPLL) duhet të përfshihet një rregull e cila rregullon rritjen e pagave të punonjësve të sektorit publik. Për të siguruar që ekonomia e Kosovës mbetet konkurruese dhe pagat përcaktohen në bazë të nivelit të produktivitetit, kjo rregull duhet të bazohet në zhvillimin real ekonomik.

Objektivi 2: Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë që organizatat buxhetore përmbushin obligimet e veta ligjore lidhur me transparencën e shpenzimeve publike. Përveç kësaj, LMFPLL duhet të obligojë të gjitha organizatat buxhetore të publikojnë në uebfaqen e tyre zyrtare "Kartelën Analitike të Kontos". Dokumentet duhet të publikohen në formën 'excel' me qëllim që të mund të

adaptohen lehtë për qëllime analizimi ose monitorimi nga ana e aktorëve përkatës.

Objektivi 3: Ligji për Buxhetin nuk përfshinë asnjë objektiv lidhur me vijat buxhetore. Përveç kësaj, Ligji për Buxhet përmban përvetësime të paqarta të vijave buxhetore të cilat bëjnë që monitorimi të jetë jo i qasshëm dhe i vështirë. Me qëllim që anëtarët e kuvendit dhe aktorët tjerë ta kenë më të lehtë të monitorojnë efikasitetin e shpenzimeve buxhetore, Qeveria e Kosovës duhet të përpilojë Programin Buxhetor. Përparësia kryesore e programit buxhetor është që vijat buxhetore strukturohen sipas synimeve të Qeverisë, duke e bërë kështu të lehtë të kuptohet dhe monitorohet.

Objektivi 4: Në nivel nacional, vetëm rreth 15% - 20% e të hyrave të buxhetit të komunave përbëhet nga të hyrat e burimeve të veta, përderisa pjesa tjetër përbëhet nga grantet e nivelit qendror. Varshmëria e lartë e komunave në grante është marrë për buxhetin qendror e cila gjithë edhe pengon motivimin e komunave për gjenerimin e të hyrave nga burimet e veta. Për më tepër, ekzistojnë një numër iniciativash për krijimin e komunave të reja, por nuk është bërë asnjë studim fizibiliteti që do të tregonte qëndrueshmëri financiare. Duke marrë parasysh këto fakte dhe shifra, Qeveria e Kosovës duhet të decentralizojë financat e nivelit lokal. Përveç zvogëlimit të varësisë në grante, komunat duhet të kenë më shumë kompetenca lidhur me grumbullimin e të hyrave tatimore.

d. Politika e jashtme

Me qëllim të mbrojtjes së interesave të Kosovës në arenën ndërkombëtare, Qeveria duhet të sigurojë njohjen e pavarësisë së Kosovës, të krijojë raporte me shtete dhe institucione relevante si dhe të fokusohet në çështjet kyçe si kapitulli 35 i negociatave të Serbisë me BE, dhe anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Të gjitha këto aspekte janë të rëndësishme për promovimin e interesave politike dhe ekonomike të Kosovës, duke mbrojtur dhe përfaqësuar në këtë mënyrë interesat e qytetarëve të Kosovës.

d.1. Raportet me Parlamentin Evropian

Raportet e mira me Parlamentin Evropian janë më se të rëndësishme, posaçërisht marr parasysh faktin që Parlamenti Evropian ka fuqi të refuzojë MSA-në dhe të rifillojë procesin e negociatave, duke e kthyer kështu integrimin evropian të Kosovës vite mbrapa. Ky Parlament duhet të miratojë jo vetëm MSA-në por edhe liberalizimin e vizave.

Objektivi 1: Qeveria duhet të përpiqet të përmirësojë imazhin e Kosovës brenda Parlamentit Evropian. Kosova duhet t'i përgjigjet pozitivisht komunikimit me parlamentin.

Objektivi 2: Kosova duhet të llojë brenda Parlamentit të ri Evropian përmes rrugëve formale dhe joformale. Qeveria duhet të kultivojë marrëdhënie të mira me anë të mjeteve të tilla, si mbajtjen e mbledhjeve në mes zyrtarëve kosovar dhe atyre të Komisioneve të veçanta.

Objektivi 3: Qeveria e Kosovës duhet të krijojë një prezencë më koherente dhe të vazhdueshme në Bruksel me qëllim të angazhimit konstruktiv me aktorët kryesor. Marrëdhëniet e mira me Parlamentin janë mjaft të rëndësishme nëse Kosova dëshiron të avancojë në mënyrë sa më të sheshtë dhe të shpejtë që të jetë e mundur në zgjerim.

d.2. Avokimi për interesat e Kosovës në kapitullin 35 të negociatave

Qeveria duhet të sigurojë që interesat e Kosovës përfaqësohen në negociata me qëllim që rezultati do të ndikojë në pozitën e Kosovës në regjion dhe atë ndërkombëtare. Veçanërisht, kapitulli 35 i negociatave mes Serbisë dhe BE-së do të ndikojë në marrëdhëniet Kosovë-Serbi.

Objektivi 1: Qeveria e Kosovës duhet të marr një qëndrim lidhur me Kapitullin 35 të negociatave në mes të Serbisë dhe BE-së. Qeveria duhet të insistojë që Serbia të pajtohet se nuk do të bllokojë anëtarësimin e Kosovës në BE si dhe të shpreh përkushtimin e saj në respektimin e integritetin territorial të Kosovës.

Objektivi 2: Të llohet në Komisionin Evropian që Kosova të përfshihet si kusht në negociatat e BE-së me Serbinë, me qëllim që interesat e Kosovës të përfaqësohen si duhet gjatë diskutimeve. Për të siguruar bashkëpunim rajonal, Kosova duhet të përfshihet në organizatat regjionale si pjesë e normalizimit të raporteve në mes Serbisë dhe Kosovës si dhe Kosovës t'i mundësojë të vazhdojë rrugën e vet drejt integritetit evropian pa pengesa.

Objektivi 3: Të ftohet shoqëria civile që të merr pjesë në diskutime dhe debate lidhur me çështjet e Kapitullit 35, për të informuar më mire publikun dhe për të pasqyruar në opinion publik këtë çështje. Brenda 6 muajve, Qeveria duhet të mbajë një konferencë në të cilën do të adresohen dhe diskutohen çështjet e Kapitullit 35 nga ana e anëtarëve të shoqërisë civile.

d.3. Përkrahja e anëtarësimit në Këshillin e Evropës

Kosova duhet të prioritetizojë aktivitetet për t'iu bashkuar Këshillit të Evropës e cila gjë do të legjitimonte statusin e Kosovës si një shtet i pavarur. Kjo jo vetëm që do të bënte që Kosova të mbrojë sovranitetin e vet por edhe do t'i bënte të mundur Kosovës të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare.

Objektivi 1: Qeveria duhet të përmirësojë raportet me Këshillin e Evropës. Kosova duhet t'i përgjigjet pozitivisht kërkesave dhe nevojave të Komisionit për dokumentacione dhe raporte.

Objektivi 2: Kosova duhet të llojë tek akterët e vet për të promovuar aplikimin e suksesshëm në Këshillin e Evropës. Integrimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare nuk do të jetë i plotë pa u anëtarësuar në Këshill, duke e bërë atë si prioritet të politikës së jashtme.

Objektivi 3: Kosova duhet të kërkojë opinione ligjore në Komisionin e Venecias (që ndihmon vendet anëtare të vlerësojnë institucionet e veta demokratike dhe legjislacionin) me qëllim të harmonizimit të legjislacionit ekzistues dhe projektligjeve me standardet evropiane. Brenda 3 muajve të paraqiten për opinion ligjor tri ligje të ndara të cilat janë në fuqi ose draft ligje, tek Komisioni i Venecias.

e. Politikat sociale

Punësimi dhe mirëqenia sociale asnjëherë nuk kanë qenë prioritate parësore për asnjërin nga koalicionet qeveritare deri në tani. Shkalla e papunësisë strukturore mbetet mjaft e lartë, asistenca sociale është e pamjaftueshme krahasuar me rritjen e çmimeve të mallrave dhe ekziston një mospërputhje në mes të programeve edukative dhe tregut të punës. Një strategji e re e punësimit dhe politika më të mira sociale duhet të jenë prioritate kyçe në Planin e ri strategjik të qeverisë.

e.1. Strategjia e re për punësim

Ndonëse të dhënat nga Zyra për Statistika tregojnë ulje në shkallën e punësimit nga 30.9% në 30.0% brenda vitit të kaluar, numri i kërkuesve për punë të regjistruar është rritur. Numri i përgjithshëm i kërkuesve të regjistruar për punë në qershor ishte 272,093, numër ky i cili është rritur për 2.5% krahasuar me vitin e kaluar. Një shqetësim tjetër i madh është që numri i punëkërkuesve me arsimim universitar është rritur për 16.7% brenda një viti sipas të dhënave nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kjo tregon që krijimi i vendeve të punës është mjaft i rëndësishëm për Kosovën.

Objektivi 1: Qeveria e Kosovës duhet të krijojë një strategji të re të punësimit brenda një (1) viti të lëshimit të Planit të ri. Kjo strategji duhet të përmbajë objektiva të qarta dhe të matshme për të rritur shkallën e punësimit dhe për të ofruar planet dhe mjetet për arritjen e këtyre objektivave. Strategjia duhet të specifikojë numrin e vendeve të punës të cilat synohen të krijohen gjatë viteve të ardhshme, numrin e trajnimeve dhe aktiviteteve për zhvillim profesional, numrin e bizneseve që do të bëhen zyrtare (të regjistruara) dhe numrin e

familjeve që do të largohen nga skema e asistencës sociale pas punësimit të një anëtarit të familjes.

Objektivi 2: Qeveria e Kosovës duhet të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me punëdhënësit me qëllim të rritjes së numrit të punonjësve. Qeveria duhet të ndajë grante si pako stimuluese që ka për synim rritjen e numrit të punonjësve në biznese shume të vogla, si dhe në ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Pakoja stimuluese duhet të jetë e qartë përfshirë procedurat e aplikimit. Kjo skemë e ndarjes së grantit duhet të bëhet brenda një (1) viti.

Objektivi 3: Qeveria e Kosovës duhet të alokojë një buxhet më të madh për politikat e punësimit. Buxheti aktual për politikat aktive të punësimit është mjaft i ulët, (0.026% e buxhetit të Kosovës) dhe joefikas për të prekur problemet e papunësisë strukturale. Qeveria duhet të rrit buxhetin për politikat e punësimit gjatë fazës së ardhshme të planifikimit buxhetor.

e.2. Politika më të mira sociale

Qeveria e Kosovës duhet të krijojë mekanizma me qëllim që të sigurojë se të drejtat e punonjësve respektohen në tërësi. Kjo përfshinë zbatimin e plotë të Ligjit të Punës, rritjen e resurseve njerëzore dhe teknike të inspektoratit të punës, rritjen e dialogut social, dhe përmirësimin e skemës së asistencës sociale.

Objektivi 1: Qeveria e Kosovës duhet të bëjë një analizë të duhur të funksionimit dhe zbatimit të Ligjit të Punës. Disa observime tregojnë se shumica e Neneve të Ligjit nuk janë zbatuar si duhet e në veçanti në sektorin privat, si lëshimi i kontrateve me shkrim të punës, përdorimi i pushimit të lehonisë dhe atij mjekësor dhe respektimi i orëve të punës. Një analizë e duhur e zbatimit të Ligjit do të tregonte nëse ekziston nevoja e ndryshimit të pjesëve të caktuara në Ligj, ose për fuqizimin e organeve mbikëqyrëse, siç është Inspektorati i Punës. Analiza e tillë duhet të bëhet brenda tre muajve të krijimit të planit të ri strategjik.

Objektivi 2: Qeveria e Kosovës duhet të rrit kapacitetet njerëzore dhe teknike të inspektoratit të punës, si organ kryesor përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjit. Numri aktual i inspektorëve të punës është i pamjaftueshëm dhe për këtë arsye efektiviteti i tyre për të rregulluar kushtet e punës vështirësohet. Përveç kësaj, Qeveria duhet të rishikojë buxhetin për Inspektoratin e Punës dhe të gjejë mundësi për rritjen e buxhetit të vet vjetor ose për gjetjen e modeleve për gjenerimin e të hyrave vetanake. Në fazën tjetër buxhetore, qeveria duhet të ndajë fonde për inspektorë shtesë të punës duke rritur fondet për Inspektoratin e Punës dhe /ose të ofrojë alternativa dhe plane gjithëpërfshirëse për Inspektoratin që të gjenerojë fonde.

Objektivi 3: Qeveria duhet të rishikojë urgjentisht skemën e asistencës sociale. Në përgjithësi, shumica e asistencës sociale duhet të rritet që të jetë e mjaftueshme për të plotësuar nevojat themelore të një familje. Përveç kësaj, duhet të ketë kontrollime të rrepta për të siguruar që individët të cilët nuk kanë të drejtë për dobi të tilla të mos shfrytëzojnë përparësitë e asistencës sociale. Brenda një viti, Qeveria duhet të ofrojë trajnime institucioneve përkatëse dhe duhet të rishikojë efektivitetin e vet për të vlerësuar nevojën dhe legjitimitetin e aplikuesve për asistencë sociale. Në buxhetin e ardhshëm Qeveria duhet të rrit fondin për mirëqenie sociale për familje, me qëllim që nevojat e tyre themelore të mund të plotësohen.

Objektivi 4: Ekziston një nevojë urgjente për të përmirësuar cilësinë e dialogut në mes punëdhënësve dhe punëtorëve në Kosovë. Qeveria dhe Këshilli Social dhe Ekonomik (KSE) duhet të gjejnë një model të ri të dialogut që sjell rezultate më konkrete. Brenda tre (3) muajve duhet të bëhet vlerësimi i zbatimit dhe sfidave të Kontratës së përgjithshme Kolektive. Nëse është e nevojshme, të propozohet një model i ri i KSE me përbërje të ndryshme.

V. Çështjet ekonomike

Që Kosova të përmirësojë funksionimi e ekonomisë, qeveria duhet të bëjë disa përpjekje. Shqyrtimi i politikave aktuale të energjisë është më se i nevojshëm, si dhe çështjet e stagnuar dhe të pazgjidhura nga procesi i privatizimit, adresimin e statusit të Xehes së Trepçës, prokurimit publik, çështjet që kanë të bëjë me tregti, dhe investimet e drejtpërdrejta të huaja, e që të gjitha kërkojnë vëmendje të menjëhershme

a. Zhvillimi Ekonomik

Ekonomia e Kosovës është duke u përballur në mënyrë të vazhdueshme me nivele të larta të papunësisë, e përcjellë me BPV për kokë banori e cila është më e ulëta në rajon. Mungesa e një strategjie të mirëfilltë e cila do të fokusonte burimet e pakta drejt zhvillimit ekonomik është njëra nga arsye e cila ka shkaktuar këtë gjendje. Në anën tjetër, edhe pse ambienti i të bërit biznes është përmirësuar, zbatimi i kontratave si njëri nga faktorët kryesorë i cili ndikon investimet vendore dhe të huaja tejet joefikas.

Objektiva 1: Në mënyrë që orientohen burimet në formë efektive, Qeveria e Kosovës duhet të hartonte një strategji të detajuar të zhvillimit ekonomik e cila përfshinë objektiva edhe masa konkrete për secilin sektorë të ekonomisë. Strategjia duhet të ketë kosto të qartë dhe të implementohet gjatë hartimit të buxhetit vjetor të Kosovës.

Objektiva 2: Zbatimi i kontratave është një faktor shumë i rëndësishëm i cili ndikon tek një numër i madh i çështjeve ekonomike siç janë: shkalla e interesit në kredi, investimet e huaja direkte, rritja e bizneseve ekzistuese, likuiditeti në ekonomi etj. Banka Botërore e ka renditur Kosovën në vendin e 138 nga 189 vende në botë sa i përket këtij aspekti. Qeveria e Kosovës duhet të caktojë në mënyrë urgjentë objektiva dhe masa të qarta sa i përket përmirësimit të zbatimit të kontratave dhe rritjes së efikasitetit në zbatimin e tyre.

Objektiva 3: Kapitali njerëzor është njëri nga faktorët më të rëndësishëm i cili ndikon në mirëqenien e qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Një fuqi punëtore e edukuar përveç se sjellë vlerë të shtuara direkte në ekonomi, gjithashtu është një nga faktorët e rëndësishëm i tërheqjes së investimeve të huaja. Duke marrë parasysh që Kosova ka një popullsi me moshën më të re në Ballkan, investimi në edukim duhet të konsiderohet i një rëndësie strategjike. Deri më tani një pjesë e madhe e buxhetit shtetëror është shpenzuar në infrastrukturë rrugore, ndërsa edukimi ka përfituar shumë më pak nga investimet kapitale. Në mënyrë që të rritet kualiteti i edukimit, Qeveria e Kosovës duhet të rrisë shpenzimet në arsim në të gjitha nivelet dhe t'i kushtojë rëndësi më të madhe trajnimit profesional.

Objektivi 4: Edhe pse sistemi tatimor i Kosovës është i favorshëm për bizneset, me taksat duke qenë më të ulëtat në rajon, administrimi i tyre paraqet një nga sfidat më të mëdha për të bërë biznes. Taksa e cila sjell më së shumti të ardhura, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, mbledhet ende në kufi, përpara se produkti të jetë shitur. Kjo mënyrë e mbledhjes së taksave jo vetëm që paraqet një vështirësi teknike në pagimin e taksave, por edhe bllokon kapitalin nga bizneset pasi që ata duhet të paguajnë për të para se të jetë shitur produkti. Kjo praktikë e ulë likuiditetin tek bizneset dhe përgjithësisht në ekonomi dhe gjithashtu kufizon kapacitetin e bizneseve për investime.

Objektivi 5: Informaliteti paraqet një ndër sfidat më të ashpra për funksionimin e tregut të lirë në Kosovë. Është vlerësuar se ajo kontribuon deri 35 për qind në BPV. Problem i përhapur i informalitetit, jo vetëm që krijon konkurrencë të padrejtë në mes firmave në treg (sidomos ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që i kontribuojnë më së shumti punësimit), por edhe krijon hapësirë për vendime arbitrare dhe politikisht të ndikuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Meqë informaliteti është kaq i përhapur në ekonomi, kjo kërkon që firmat e rregullta domosdo të bashkëpunojnë me sektorin joformal, gjë e cila i bën ata të prekshëm prej administratës tatimore. Për këtë arsye, autoriteti tatimor mund të ndëshkojë pothuajse çdo biznes që dëshiron. Ky fenomen rritë

koston e të bërit biznes, pasi që bizneset gjithashtu duhet të llogarisin rryshfetet dhe favoret politike.

Objektivi 6: Qeveria e Kosovës duhet të ndryshojë qasjen e krijimit të Zonave të Lira Ekonomike. Krijimit të zonave të reja ekonomike duhet t'i paraprijë një studim i fizibilitetit, ku aplikuesi do të shpjegonte arsyeshmërinë ekonomike, fiskale, ligjore dhe administrative. Praktika e shpalljes së zonave të lira ekonomike pa studim të fizibilitetit dhe në mënyrë të përsheptuar siç ka ndodhur me shpalljen e Gjakovës, Mitrovicës dhe Prizrenit si zona të lira ekonomike nuk do duhej të përsëriten. Qeveria e Kosovës do duhej të rishikonte edhe statusin e zonave aktuale ekonomike në Kosovë, shumë prej të cilave ende nuk e kanë statusin e definuar ndonëse funksionojnë si zona ekonomike. Për më tepër, Qeveria do duhej të krijonte një strategji të re për promovimin e zonave ekonomike tek investitorët e huaj dhe lokal, duke i potencuar stimuluesit financiar dhe lehtësimet tjera që parasheh Ligji për Zonat Ekonomike.

b. Ndërmarrjet Publike

Ndërmarrjet Publike në Kosovë ofrojnë shërbime themelore për mirëqenien e qytetarëve si dhe zhvillimin ekonomik. Shërbimet e tyre përfshijnë sektorët si: energjia, uji i pijshëm, menaxhimi i ujërave të zeza, menaxhimi e mbeturinave, transporti urban, telekomunikacioni etj. Megjithatë, shumica e kompanive ballafaqohen me humbje të mëdha tregtare dhe të shpërndarjes, joefikasitet të madh, mungesë të përmirësimit të objektivave operativ etj. Shkaqet kryesore për problemet e lartpërmendura janë: mjedisi i vështirë i biznesit dhe ndërhyrjet politike.

Objektivi 1: Sipas një studimi të bërë nga Instituti GAP, një nga faktorët kryesorë që ka rezultuar në mbi-punësim në ndërmarrjet publike është ndikimi i politikës në procesin e zgjedhjes së bordit të drejtorëve. Në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi i politikës, Qeveria e Kosovës duhet të amandamentojë Ligjin për Ndërmarrjet Publike duke përfshirë në të cilat sigurojnë transparencën e procesit. Praktikën e mira të transparencës të sugjeruara nga OECD përfshijnë: a) publikimin online të emrave të kandidatëve për anëtarë të bordit dhe metodologjinë e vlerësimit; b) përfshirjen e agjencive të specializuara të rekrutimit; c) përfshirjen e shoqërisë civile në proces në rolin e mbikëqyrjes.

Objektivi 2: Qeveria e Kosovës duhet të hartojë një plan i cili parasheh rënie graduale në numrin e të punësuarve në ndërmarrjet publike. Kjo do të: a) rriste efikasitetin apo vlerën e ndërmarrjeve; b) të shmangte shkarkimin masiv në rast të privatizimit, pra rritë numrin e njerëzve me përfitimeve sociale. Planet e zvogëlimit të stafit duhet të përfshijnë punonjës në fazën e hartimit dhe të

kompensoj ata nëpërmjet: parave, rikualifikimit apo rivendosjes në institucione të tjera.

Objektivi 3: Për të përmirësuar qeverisjen e përbashkët në ndërmarrjet në nivel qendror dhe lokal, Qeveria e Kosovës duhet të rrisë kapacitetet njerëzore në Njësinë për Politika dhe Monitorim të ndërmarrjeve publike nën Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Objektivi 4: Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me kompanitë publike duhet të ndërtojë planet, në konsultim me Universitetet Publike dhe Private në Kosovë, të cilat synojnë të ndërtojë programe të studimeve në fushat ku kërkesat e këtyre kompanive janë më të mëdha.

c. Privatizimi

Procesi i privatizimit në Kosovë është pasuar me kritika të forta. Shpesh është referuar si 'privatizim masiv' që pavarësisht rëndësisë, privatizimi ka përfshirë të gjitha NSH-të të cilat duhej t'iu shiteshin sa më shpejt investitorëve privatë nëpërmjet një procedure të tenderimit. Qëllimi ka qenë që të shesë NSH-të pa një strategji të qartë afatgjate lidhur me përfitimet dhe pasojat mbi të punësuarit, si dhe ekonominë në përgjithësi. Mund të thuhet se procesi kishte për qëllim transferimin e të drejtave të pronësisë te pronarët privatë dhe jo domosdoshmërisht të arrijë qëllimet e saj ekonomike. Në përgjithësi, procesi është karakterizuar nga disa probleme midis të cilave mungesa e investitorëve serioz (ato të huaja në veçanti), korrupsionit, çmimeve simbolike të shitjes, normave të larta të humbjeve të vendeve të punës, si dhe ngrirjes së fondeve të privatizimit. Thënë këtë, edhe pse procesi i privatizimit është gati të përfundojë, vetëm disa ndërmarrje të privatizuara mund të konsiderohen si të suksesshme dhe në përgjithësi është perceptuar që ky proces nuk ka përmbushur pritjet. Qeveria duhet të:

Objektivi 1: Pezullojë procesin e privatizimit, edhe pse ai po i afrohet fundit të saj, në mënyrë që të parandalojë probleme të mëtejshme, parregullsi dhe veprime korruptive.

Objektivi 2: Hetojë plotësisht rastet e mëparshme të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe këshillojë institucionet e sundimit të ligjit për të miratuar një qasje më proaktive në hetimin e rasteve korruptive (veprimet e lartpërmendura duhet të përfundojnë brenda një (1) viti).

Objektivi 3: Brenda një viti, në bashkëpunim me Parlamentin, të krijojë një plan strategjik se si të vazhdohet me NSH-të e pa-privatizuara.

Objektivi 4: Sigurojë që procesi i monitorimit të jetë më efektiv dhe investitorët që nuk arrijnë të plotësojnë kushtet e parapara duhet të dënohen siç duhet. Për

më tepër, autoritetet duhet të nxjerrin udhëzime, brenda dy (2) muajve, për mënyrat më efektive për të mbledhur gjrobat, përndryshe lëshimi i gjobave nuk do të jetë efektiv dhe investitorët nuk do të nxiten ti binden obligimeve që rrjedhin nga kontrata.

d. Kompleksi Minerar Trepça

Kompleksi Minerar Trepça përfaqëson një gjigant të rëndësishëm dhe të vlefshëm ekonomik që ka një rëndësi të jashtëzakonshme në drejtim të zhvillimit të ardhshëm ekonomik të Kosovës. Megjithatë, ajo përfshin shumë probleme që rrjedhin nga mungesa e investimeve, stagnimit teknik dhe teknologjik, mungesës së stafit profesional, statusit të pazgjidhur të pronësisë, dhe qasjes menaxhuese destruktive nga ana e Qeverisë së Serbisë. Trepça, ndërmarrje nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) miniera dhe vetëm katër (4) prej tyre janë aktive. Minerat kanë përjetuar një rënie masive në prodhim dhe aktualisht prodhojnë vetëm koncentrat të plumbit dhe zinkut, që do të thotë çmime dhe fitime më të ulëta. Për më tepër, Trepça ka trashëguar probleme të ndryshme si ato sociale, teknologjike dhe mjedisore, të cilat kanë pasur një ndikim negativ në funksionimin e Trepçës. Qeveria duhet të:

Objektivi 1: Të hartojë një ligj specifik për Trepçën, brenda gjashtë (6) muajve, e cili do të ofrojë zgjidhje për çështjet e pronësisë, minierat, pretendimet e kreditorëve, të drejtat minerale dhe të shfrytëzimit, investime potenciale, programet sociale dhe të drejtat dhe kompensimi i punonjësve, ndër të tjera.

Objektivi 2: Të kërkojë ndihmë nga institucionet financiare ndërkombëtare (ekspertë) për të kryer një vlerësim të gjendjes aktuale të Trepçës duke përfshirë asetet thelbësore dhe jo-thelbësore, burimet natyrore të huluntuara dhe të pahuluntuara, detyrimet e akumuluarra financiare dhe ndikimi mjedisor. Vlerësimi i përgjithshëm duhet të përfundojë brenda gjashtë (6) muajve.

Objektivi 3: Të sigurojë investime vendore dhe të huaja, sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që të fillojë faza e rivitalizimit të Trepçës.

e. Prioritetet e Energjisë

Sektori i energjisë është në nevojë alarmante për kujdes dhe vëmendje nga Qeveria e Kosovës. Ky sektor është në gjendje kaotike dhe rrezikon jostabilitet social dhe ekonomik nëse nuk prioritetizohet. Deri më tani, është diskutuar shumë por është bërë pak. Ndotja që vije nga Termocentrali Kosova A është shqetësim që duhet të adresohet urgjentisht duke e mbyllur impiantin. Rritja e çmimit të rrymës elektrike vetëm ka shkaktuar trazira sociale dhe kërcënon të shkaktojë më shumë protesta. Në anën tjetër, debatet për energjinë në Kosovë

janë fokusuar në aspektin e energjisë elektrike, duke neglizhuar çështjet e efijencës energjetike, ngrohjes dhe ftohjes. Duke i marrë parasysh këto çështje, Plani i ardhshëm Strategjik i Qeverisë së Kosovës duhet të fokusohet dhe të prek çështjet e këtyre apekteve energjetike, përfshirë prodhimin e energjisë, pastaj ngrohjes dhe ftohjes, dhe përmirësimin e efijencës energjetike.

e.1. Prodhimi i energjisë

Prodhimi i energjisë është njëra nga fushat më të rëndësishme të energjisë në Kosovë. Prandaj, duhet t'i kushtohet vëmendje e nevojshme meqë problemet e tilla janë me pasoja jo vetëm për këtë sektor por për tërë shoqërinë.

Objektivi 1: Qeveria duhet të punojë në mbylljen e Termocentralit Kosova A deri ne vitin 2017, për shkak të ndotjes alarmante që shkakton dhe jo-qëndrueshmërisë në kuptim të prodhimit të energjisë dhe sigurisë për punëtorët e vet. Çdo vonesë në mbylljen e Kosovës A jo vetëm që do të përkeqësojë situatën mjedisore dhe të rrezikojë sigurinë e punëtorëve, por edhe do të shkel përkushtimin e bërë tek BE-ja dhe Sekretariati Energjetik për mbylljen e impiantit deri në vitin 2017.

Objektivi 2: Mbyllja e Kosovës A dhe rritja e kërkesës për energji kërkon që Kosova B të rinovohet, zbatohen masa urgjente për zbatimin e politikave rigoroze të efijencës, dhe krijimin e kapaciteteve (alternative) të reja të prodhimit. Hapësira në mes ofertës dhe kërkesës për energji paraqet kërcënimin për një regjim errësimi të plotë me një furnizim jostabil të energjisë. Për më tepër, në përpjekjen për të zgjidhur zbrazëtinë energjetike, Kosova do të duhet të importojë energji, e cila kushton shumë për shkak të mungesës së prodhimit të mjaftueshëm të energjisë në rajon. Çmimi i lartë i importit do të shter konton nacionale të Kosovës dhe do të rrit çmimin e energjisë elektrike.

Objektivi 3: Kosova duhet të nxisë dhe zhvillojë në mënyrë agresive resurset e ripërtërishme të energjisë. Pjesa aktuale e energjisë e cila është duke u prodhuar nga energjia e ripërtërishme (2% e prodhimit të përgjithshëm të energjisë) e energjisë totale duhet të rritet. Përveç kësaj, Kosova duhet të zbatojë caqet 20/20/20 të përcaktuara nga BE-ja. Kjo rritje duhet të nxitet duke lehtësuar procedurat dhe lejet dhe duke përcaktuar tarifat furnizuese për të gjitha burimet e energjisë së ripërtërishme.

e.2. Rritja e efijencës energjetike

Efijencia energjetike është njëra nga lidhjet e dobëta në zinxhirin energjetik. Qeveria e Kosovës vetëm së fundi ka filluar të përqendrohet më shumë në çështjet që kanë të bëjnë me efijencën energjetike. Megjithatë, ekziston mjaft

hapësirë për përmirësimin e efijencës energjetike në prodhim, transmetim dhe përdorimin final.

Objektivi 1: Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale në sistemin e distribuimit duhet të vazhdojë të mbetet prioritet i Qeverisë, pavarësisht faktit se rrjeti i distribuimit dhe furnizimit u privatizuan me qëllimin kryesor për të zvogëluar humbjet. KEDS-i i privatizuar së fundi duhet të vazhdojë të ndihmojë Qeverinë e Kosovës në zvogëlimin e humbjeve komerciale.

Objektivi 2: Çështja e debatuar pak e përdorimit final të energjisë efijente duhet të prioritetizohet në agjendën dhe politikat e Qeverisë. Sondazhet dhe analizat e kryera në këtë fushë tregojnë rezultate jo të mira. Një pjesë e madhe e shtëpive nuk janë të izoluar si duhet dhe pajisjet elektrike janë të vjetra dhe joefikase. Qeveria duhet të trajtojë këto probleme përmes krijimit të Fondit për Energji Efijente, duke kryer auditime në këtë fushë si dhe duke ndryshuar ligjin për ndërtimtari në dobi të energjisë efijente.

Objektivi 3: Komunat në veri të Kosovës në përgjithësi mbesin jashtë shtrirjes së Institucioneve të Kosovës. Institucionet e Kosovës ende nuk kanë kontroll të plotë për regjionin e veriut të Kosovës. Si pasojë, tërë energjia e futur në rrjetin elektrik mbetet e pafaturuar. Për më tepër, Hidrocentrali i Gazivodës dhe nënstacioni i rëndësishëm i Vellaçit janë në veri. Ndonëse ky synim nuk i takon kategorisë së efijencës energjetike, zgjerimi i institucioneve të Kosovës në veri do të përmirësojë padyshim faturimin dhe shpërndarjen e energjisë, e cila gjë do të rriste efijencën energjetike.

e.3. Fokusi në ngrohje dhe ftohje

Çështja e ngrohjes dhe ftohjes asnjëherë nuk ka arritur të futet në debate publike ose agjendën e qeverisë. Kur vie dimri, çështja e tarifave dimërore menjëherë përfshihet në debate të nxehta, megjithatë, shkaktarët fundamental mezi përmenden. Prandaj, Qeveria e Kosovës duhet të fillojë të fokusohet më shumë në ngrohje dhe ftohje dhe të gjejë mënyrën për zgjidhjen e problemeve të ngrohjes.

Objektivi 1: Qeveria e Kosovës duhet urgjentisht të gjejë zgjidhje për problemin e ngrohjes. Mbështetja në opsionin e zjarrit me dru dhe elektricitet nuk është zgjidhje praktike dhe e qëndrueshme. Për shkak të konsumit të tepruar të druve, pyjet janë duke vuajtur nga shkalla e lartë e shpyllëzimit. Për më tepër, me paraqitjen e dy parqeve nacionale në Rugovë dhe male të Sharrit, ku drunjtë nuk mund të merren më, pyjet tjera rrezikohen të shpyllëzohen në masë të madhe. Në anën tjetër, përdorimi i elektricitetit për ngrohje jo vetëm që nuk është efijent por edhe krijon rritje në kërkesën për energji që nuk mund të mbulohet nga kapacitetet vendore të prodhimit.

Objektivi 2: Qeveria e Kosovës duhet të gjejë mënyra për t'u lidhur në Gazsjellësin Trans-Adriatik (GTA), gazsjellës natyral i cili do të kalojë përmes Shqipërisë dhe do të sjell gazin nga Azerbajxhani. Megjithatë, një lidhje e tillë kërkon infrastrukturë gazi e cila aktualisht mungon në Kosovë. Prandaj, Qeveria e Kosovës duhet të planifikojë krijimin e infrastrukturës së nevojshme të gazit duke u përpjekur të gjejë mënyra për lidhje në GTA.

f. Prokurimi Publik

Prokurimi publik përbën një të pestën e BPV dhe konsiderohet si shtytës i rëndësishëm i ekonomisë së Kosovës. Megjithatë, prokurimi publik ballafaqohet me dy probleme madhore: atë të mungesës së transparencës dhe llogaridhënies, duke rrezikuar kështu integritetin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik. Shumë praktika jo të mira janë evidentuar edhe në Raportin e Progresit , veçanërisht problemet me menaxhim kontratash dhe ngritja e kapaciteteve nga sistemi i prokurimit në Kosovë. Për më tepër, janë disa boshllëqe/mangësi të tjera që hasen në praktikë dhe në legjislacion duke përfshirë cilësinë e profesionalizmit në mesin e stafit të prokurorit, mungesa e vullnetit politik për të nxitur reformat politike përpara, mungesën e kapaciteteve të vendit për të kryer këshillim të politikë-bërjes dhe strukturën e vendimmarrjes, karteli i tenderimit (cartel-bidding), vendosjen e paligjshme të kriterëve teknike, mungesa e vlerësimit të nevojave dhe fondeve të mjaftueshme, oferta jashtëzakonisht të ulëta, falsifikim të dokumenteve zyrtare nga operatorët ekonomikë, vonesa rreth zbatimit të projekteve, mungesa e prokurimit qendror. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet:

Objektiva 1: Të sigurojë vendosjen e një praktike më të mirë në të gjitha organizatat buxhetore për precizimin e kriterëve teknike si një nga parakushtet kryesore për të siguruar që paratë publike të shpenzohen në një mënyrë të drejtë dhe transparente.

Objektiva 2: Të sigurojë krijimin e listës referente të çmimeve përmes parlamentit, e cila tashmë nuk është e rregulluar me Ligjin mbi Prokurimin. Lista referente e çmimeve është një listë e artikujve e bazuar në çmimin e tregut. Prandaj, kur operatorët ekonomik aplikojnë me ofertat e tyre, organizatat buxhetore mundën me i vlerësuar në bazë të asaj liste. Kështu që çdo operator ekonomik mund të diskualifikohet në përputhje me çmimet referente.

Objektiva 3: Të krijojë një listë për mallrat dhe shërbimet e përbashkëta për prokurim të centralizuar në përputhje me Ligjin mbi Prokurimin, me ndihmën e parlamentit. Kështu që Agjencia të drejtojë procesin e prokurimit publik, me qëllim të rritjes së efikasitetit përmes zvogëlimit të kostove të transaksionit dhe

çmimeve përmes reduktimit të kostos së prodhimit dhe përmes grumbullimit të ofertës, gjë që përmirëson menaxhimin e informacioneve.

Objektiva 4: Të sigurojë që parlamenti të vendose nxjerrjen e një akti nënligjor i cili kufizon rritjen e çmimit të kontratës në jo më shumë se 3-5%. Kjo rritje mundëson mbulimin e shpenzimeve të vogla të pa planifikuara, apo shpenzimet të tjera që nuk janë paraparë me kohë apo që kanë dalë gjatë realizimit të projekteve.

Objektiva 5: Të sigurojë implementimin e E-prokurimit i cili do të shërbente si mekanizëm për parandalimin, zbulimin dhe dënimin e akteve të korrupsionit. Të gjitha dokumentet do të ruhen në një sistem elektronik, dhe çdo përpjekje për ndryshimin e tyre do të mund të zbulohet lehtë. E-prokurimi mundëson procesin online të të gjitha aktiviteteve të prokurimit nga shpallja e tenderit e deri te kryerja e pagesës për operatorët ekonomik.

g. Tregtia

Gjatë dekadës së fundit Kosova ka shënuar performancë të dobët në indikatorët tregtar – deficitin i lartë tregtar, bazë të dobët të prodhimit dhe eksporteve, si dhe shkallë të lartë të importeve - që tregojnë gjendjen e dobët ekonomike në Kosovë. Edhe pse në vitin 2013 kishte përmirësime të vogla të këtyre indikatorëve, në shtatë muajt e parë të vitin 2014 eksporti ka shënuar rënie prej 0.4% ndërsa importi është rritur për 1.2% duke rritur poashtu edhe deficitin tregtar.

Objektiva 1: Politika kryesore ekonomike e Kosovës është që të mbledhë të hyra buxhetore përmes tarifave të vendosura, pasi që ekonomia e saj është tepër e varur nga importet. Thënë këtë, Kosova duhet të ndryshojë politikën e saj ekonomike duke përdorur tarifën për të caktuar prioritetet dhe për të mbrojtur sektorët dhe industrinë e ndjeshme pasi që kjo do të çonte në rritje ekonomike dhe qëndrueshmëri. Ndërsa, në periudhën afatmesme, Kosova duhet gradualisht të krijojë reforma tatimore të nevojshme për të gjeneruar të hyrat qeveritare dhe për të zëvendësuar humbjet buxhetore si pasojë e tregtisë së lirë, që sipas institucioneve do arrijnë deri në € 20 milionë në vit.

Objektiva 2: Institucionet e Kosovës duhet të përmbushin të gjitha kërkesat e nevojshme lidhur me produktet dhe industrinë (në veçanti ato me potencial ekonomik) gjatë periudhave transitorë të caktuara në MSA. Pas largimit të barrierave tregtare, qeveria e Kosovës dhe institucionet duhet të ushtrojnë kontroll të rregullt të tregut, të forcojnë pozitën në tregun e brendshëm, si dhe të zbatojnë standardet e nevojshme.

Objektiva 3: Qeveria e Kosovës duhet të përmbushë të gjitha kërkesat Sanitare dhe Fitosanitare të cilat krijojnë një pengesë të konsiderueshme në eksportin e produkteve ushqimore dhe bujqësore. Për më tepër, Qeveria e Kosovës duhet të miratojë masat Sanitare dhe Fitosanitare në mënyrë që të zvogëloj barrierat tregtare pa rrezikuar aftësinë e imponimit të masave të tilla të nevojshme për të mbrojtur jetën e kafshëve, njerëzve dhe bimëve.

Objektivi 4: Qeveria e Kosovës duhet ta zvogëlojë deficitin tregtar duke bashkëpunuar me komunitetin e biznesit, duke ofruar fushata vetëdijesuese dhe duke propozuar reforma reale të cilat do të ofrojnë stimulim për bizneset në mënyrë që të rriten investimet, kapacitetet prodhuese dhe prodhimi vendor në përgjithësi.

h. Investimet e Huaja Direkte

Aftësia e Kosovës për të tërhequr investime të huaja direkte mbetet e kufizuar. Përveç mungesës së ndërgjegjësimit në lidhje me potencialin për investime në Kosovë, flukset hyrëse të investimeve të huaja janë penguar edhe nga shkalla e lartë të korrupsionit, reformat jo-efektive e të bërit biznes, mungesa e transparencës, pasiviteti ekonomike në shumë sektorë, perceptimin dhe imazhi negativ nga investitorët e huaj dhe diaspora, si dhe dështimi i institucioneve për të zbatuar dhe arritur objektivat e tyre të përcaktuara.

Objektivi 1: Qeveria e Kosovës duhet të përqendrohet në këto katër politika kryesore: të zvogëlojë pengesat ndaj IHD-ve duke ndërmarrë reforma të mëtejshme në mjedisin e biznesit dhe duke siguruar zbatimin e plotë të reformave ekzistuese; të rris atraktivitetin e sektorëve kryesorë duke ofruar politika të reja, rregullore dhe infrastrukturë moderne; të përqendrohet në lloje të veçanta të IHD-ve të cilat kanë potencial të madh dhe të dobishme për ekonominë e vendit, veçanërisht në rajonet më pak të zhvilluara; dhe të rris konkurrueshmërinë e Kosovës për tërheqjen e IHD-ve duke ofruar programe stimuluese.

Objektivi 2: Qeveria duhet të zhvillojë politika të mirëfillta dhe inovative, rregullore dhe infrastrukturë për të rritur konkurrencën dhe atraktivitetin e sektorëve kryesorë (proceset biznesore të kontraktuara nga jashtë, energjia e ripërtërishme, përpunimi i drurit dhe metalit, procesimi dhe paketimi i ushqimit, agrobiznesi, dhe tekstili). Qeveria duhet të rrisë përpjekjet duke iu përgjigjur nevojave të investitorëve në këto sektorë si dhe të zvogëlojë pengesat e të bërit biznes.

Objektivi 3: Qeveria e Kosovës duhet të konsiderojë ofrimin e politikave dhe stimuluesve fiskal të cilat duhet të përmbushin objektivat e zhvillimit

ekonomik. Qeveria duhet të marrë parasysh pasurimin e paketës stimuluese fiskale duke inkuadruar stimulues të tjerë si investimet e njohura si 'Tax Holidays' (reduktim apo eliminim i përkohshëm i taksave për investime të caktuara), apo/ose edhe 'Export Processing Zones' të cilat janë një lloj i zonave të tregtisë së lirë për të promovuar eksportet industriale dhe komerciale posaçërisht në zona të pazhvilluara të vendit.

Objektiva 4: Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë një mjedis të duhur të biznesit duke drejtuar investimet e huaja drejt sektorëve kryesorë dhe jo vetëm drejtë sektorit të konsumit, gjë që në të ardhmen mund të krijojë probleme në bilancin e pagesave.

VI. Përfundim

Si përmbledhje, Qeveria e Kosovës duhet të adresojë sfidat të cilat pengojnë progresin e Kosovës në integrimin evropian, sundim të ligjit si dhe të përmirësojë klimën politike dhe ekonomike. Këto çështje janë të lidhura ngushtë dhe kërkojnë jo vetëm legjislacion gjithëpërfshirës por edhe zbatimin e legjislacionit përkatës me qëllim të adresimit të këtyre sfidave. Tregues kyç duhet të merren parasysh me qëllim të matjes së suksesit dhe shkallës së zbatimit të këtij dokumenti. Treguesit e tillë duhet të përfshijnë statistika, por duhet të vlerësojnë edhe treguesit cilësor. Qeveria duhet të merr parasysh përfshirjen e të gjitha çështjeve të diskutuara në këtë dokument si element mjaft i rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës.

